

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“AEAM COMPANY” SHPK**

**Neni 1: Emri dhe forma ligjore**

Sot më datë 03.07.2024, une i nenshkruari:

1. **ARDIAN MUKA**, lindur ne Durrës-Shqipëri, me 05-08-1967, qytetar Shqiptar, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numer karte identiteti G70805164E

themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin

**“AEAM COMPANY” SHPK**

Shoqëria rregullon veprimtarinë e saj në përputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

**Neni 2: Selia**

Selia e shoqërisë do të jetë:

**Lagjja 4, Rruga Egnatia, Pallati “Rajfi”, Zona Kadastrale 8514, Nr. Pasurie 4/33, Kati i 2-te, Durrës.**

Shoqëria mund të hapë filiale, degë apo përfaqësi në të gjithë territorin shqiptar dhe jashtë vendit.

**Neni 3: Objekti aktivitetit**

Shoqëria do të ushtrrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Tregtim me shumice e pakice, Import- Eksport te artikujve te ndryshem industriale, ushqimore, etj.
- Transport kombetar dhe nderkombetar mallrash per vete, per te trete e me qira.
- Agjensi transporti udhetaresh e mallrash.

- Shitje-blerje pasuri te paluajtshme, dhenie dhe marrje mjete me qira, asete, pasuri te paluajtshme.
- Veprimtari ne fushen e turizmit, me qellim ngritjen e hoteleve dhe fshatrave turistike te pushimit, plazheve, qendrave te arketimit brenda dhe jashte vendit, te bleje, te marre me qera, te ndertoje apo te nxise ndertimin e tyre, duke vepruar ne kete fushë e vetme apo me partnere te tjere.
- Veprimtari ne fushen e ndertimit, ndertime civile, industriale, turistike, bujqesore si ndertime te banesave, objekteve sociale, rikonstruksione, prodhim materiale ndertimi, punime infrastrukture, rruges, ujesjellesa e kanalizime, rehabilitime rruges,porte, aeroporte,etj. Germime dheu me punime eventuale murature e betonarme. Prodhim material inerte - gure. Punime karpenterie metalike.
- Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj .

#### **Neni 4: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

#### **Neni 5: Kapitali**

Kapitali i shoqërisë është **10.000 (dhjetemije) leke** i ndarë në 1 kuote.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

**ARDIAN MUKA** eshte zoterues i 1 kuote, me 100% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë ne vleren 10.000 leke.

#### **Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë Znj. Enis Mersini lindur ne Durrës-Shqiperi, me 07.05.1973, Shqiptare, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numer karte identiteti H35507194K për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

**Neni 7: Viti ushtrimor**

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

**Neni 8:Dispozitat e fundit**

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

**ARDIAN MUKA**

